

## V E N D I M

Nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/ 2012

### Mbi

#### **Mbi një ndryshim në vendimin e Këshillit Drejtues nr 28 date 15.12.2011 “Mbi Miratimin e strukturës organizative, organogramës dhe numrit të punonjësve të APD-së”**

Këshilli Drejtues në mbledhjen e tij të datës 15.10.2012 pasi mori në shqyrtim propozimin e paraqitur nga Drejtoria Ekzekutive, mbështetur në Ligjin Nr.9130, datë 08.09.2003, “Për Autoritetin Portual”, neni 18 pika d, VKM Nr.596, datë 10. 09. 2004, “Për Miratimin e Statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për Riorganizimin e tij” neni 10 pika d; Vendimin e Këshillit Drejtues Nr 24 datë 15.03.2006 “ Miratimi i Rregullores së Këshillit Drejtues “, neni 16, Vendimin e Këshillit Drejtues Nr 28 date 15.12.2011 “Per miratimin e Struktures Organizative, organogrames dhe numrit te punonjsve te APD” Me qëllim shpërndarjen e drejtë dhe përcaktimin e burimeve njerëzore të APD-së, në përputhje me zhvillimet dhe projektet e implementuara në APD.

### V e n d o s i:

1. Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Drejtues nr 28 date 15.12.2012 “Për miratimin e strukturës organizative, organogramës dhe numrit të punonjësve të APD- së për vitin 2012” si më poshtë:
  - 1.1 Në Organogramën sipas modelit v(200) Tetor 2012 bashkelidhur ketij vendimi, bëhet ndryshimi si më poshtë:
    - a) Shtohet, “Njësia e Zbatimit të Projekteve BEI dhe BERZH”, si pasojë e kalimit të vartësisë së saj nga Drejtoria e Përgjithshme Detare, në Autoritetin Portual Durrës;
    - b) Sektori aktual i Koordinimit të Projekteve, emërtohet “Njësia e Koordinimit të projekteve KE” dhe kalon së bashku me “Njësia e Zbatimit të Projekteve BEI dhe BERZH” në vartësinë e drejtuesit të Njesisë së Zbatimit të Projekteve. Ky i fundit ka vartësi të drejtpërdrejt nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv;

c) Emërtesa “Drejtoria e Administrimit dhe Marketingut” bëhet “Drejtoria e Administrimit”;

d) Në “Njesia e Zbatimit të Projekteve BEI dhe BERZH”, numri i personelit menaxhues do të jetë, specialist 2.

**1.2** Numri total i punonjësve sipas organogrames v(200) Tetor 2012 është 625 punonjës nga të cilët 154 menaxhues dhe 471 operativ.

Ngarkohet Drejtoria Ekzekutive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARE**  
**Iva CARA**

**KRYETARI**  
**Ervin MINAROLLI**  
**Anëtarët**  
**Mirela HASANAJ**  
**Genc MATAJ**  
**Ylli DYLGJERI**  
**Adrian ÇELA**  
**Agim MAKSUTI**